



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT DHE BORXHIT PUBLIK
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

Nr. 1148/8 / prot.

Tiranë, më 14.09.2018

Lënda: Dërgohet Udhëzimi "Për një shtesë dhe ndryshim në Udhëzimin plotësues "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018".

MINISTRIA/ INSTITUCIONI _____

DEGA E THESARIT _____

Mbështetur në ligjin nr. 109 datë 30.11.2017 "Për Buxhetin e vitit 2018" dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit", të ndryshuar, bashkëlidhur ju përcjellim Udhëzimin nr. 2/2 datë 14.09.2018, "Për një shtesë dhe ndryshim në Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018".

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Gelardina Prodani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT DHE BORXHIT PUBLIK

UDHËZIM

2/2 149
Nr. datë .2018

1146/7

“PËR

NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË UDHËZIMIN PLOTËSUES NR. 2, DATË
19.02.2018 ‘PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2018’”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. të ndryshuar, nenit 22, të ligjit nr.109, Datë 30.11.2017, “Për Buxhetin e vitit 2018” dhe në vijim të Udhëzimit të ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2,

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”. në kreun I. “Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me përmbajtjen si më poshtë:

“6/1. Procedura e kthimit të vlerave të llogaritura gabimisht më tepër gjatë procesit të rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, dhe që janë të evidentuara si “Mjete ne ruajtje”. në Degën e Thesarit, përshkruhet si më poshtë:

- Pas rakordimit me Degën e Thesarit për shumat e evidentuara që duhet t'i kthehen individëve, ZRPP-ja dërgon zyrtarisht në Aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë listën e ankimesve (emër, mbiemër, kopje e kartës së identitetit, si dhe referencat e llogarisë bankare të individit) me vlerat përkatëse që duhet t'i kthehen individit si dhe Akt-Rakordimin me Degën e Thesarit respektive, duke u shprehur me shkrim për kthimin e vlerave përkatëse ankimesve. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, mbas marrjes në dorëzim të kërkesës nga protokolli, përgatit kërkesën për rritjen e autorizuar për përdorimin e të ardhurave si “Mjete në ruajtje”.
- Nëpunësi zbatues dhe autorizues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, miratojnë Urdhër shpenzimin me përshkrimin “Kthim shume për rivlerësim të gabuar”. në strukturën në të cilën do të çelet fondi, i cili është kërkuar nga ZRPP, për tu kthyer dhe e paraqesin atë në Degën e Thesarit Tiranë”.

2. Pika 21, riformulohet si më poshtë:

“Fondet e rimbursuara nga donatori/kreditori, sipas projekteve përkatëse, derdhen në buxhetin e shtetit dhe regjistrohen në një zë të veçantë për t’u dalluar nga grantet dhe kreditë e tjera, me emërtimin “Rimbursim i shpenzimeve, pas vlerësimit të performancës”.

3. Pas pikës 21 shtohen pika 21/1 dhe 21/2 me përmbajtjen si më poshtë:

“21/1. Për institucionet e arsimit të lartë, që kanë përdorur të ardhurat e veta për financimin e projektit/eve, fondi i rimbursuar nga donatori/kreditori pas vlerësimit të performancës së projektit/eve në fjalë, i kalon institucionit përkatës të arsimit të lartë që ka kryer shpenzimin nga të ardhurat e veta, në masën e shpenzimit të kryer, dhe perdoret prej tij si e ardhur.”

“21/2. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, që kanë përdorur të ardhurat e veta për financimin e projektit/eve, fondi i rimbursuar nga donatori/kreditori pas vlerësimit të performancës së projektit/eve në fjalë, i kalon njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore që ka kryer shpenzimin nga të ardhurat e veta, në masën e shpenzimit të kryer, dhe perdoret prej saj si e ardhur.”

4. Në pikën 57, shtohet germa “t” me përmbajtjen si më poshtë:
“t”. Të ardhurat nga përdorimi i të drejtës së autorit në zbatim të ligjit 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.”
5. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij përfundojnë më 31 Dhjetor 2018.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Arben Ahmetaj